

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Inspektor, Drejtorja e Koordinimit të Projekteve (Kategoria III-b).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Vendimit Nr. 166, datë 24.12.2021 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2022”; Urdhër Nr.6667/1, datë 18.02.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Inspektori ka për detyrë si më poshtë:

- Inspektori i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve varet nga Drejtoria e Drejtorisë.
- Inspektori i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve ka këto detyra kryesore:
 - a. Koordinimi i projekteve të miratuara me vendim të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë.
 - b. Ndjekja e zbatimit të projekteve në procesin e zbatimit dhe mbajtja e kontakteve zyrtare me ALUZINI dhe ZVRPP për statusin juridik të pronave të prekura nga Projektet e Bashkisë Tiranë.
 - c. Përgatitja e shkresave të ndryshme drejtuar insitucioneve të ndryshme apo individëve për zbatimin e projekteve.

- d. Kordinimi me sektorë të tjerë të Insitucionit për nevoja të ndryshme në mjete apo burime njerëzore.
- e. Hartimi i një plani pune mujor të detajuar për zbatimin në kohë reale të projekteve.
- f. Lirimi i shesheve të ndërtimit për realizimin e projekteve të planifikuara.
- g. Ndjek zbatimin e afateve për zbatimin e projekteve dhe raporton tek Drejtori i Drejtorisë mbi problematikat e konstatuara duke propozuar dhe zgjidhjen e tyre.

Dokumentat që aplikanti për Inspektor në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë 30.05.2022 **ora** 16.30